

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 12 MAJ 2022

Zonja Kryetare e Kuvendit,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashura qytetare dhe qytetarë,

Kjo seancë shënon një moment jashtëzakonisht të rëndësishëm në jetën e këtij parlamenti, por, absolutisht, po kaq të rëndësishëm për shoqërinë dhe kombin shqiptar. Nisma e deputetëve të grupit të PD-së për të dënuar gjenocidin serb në Bosnje, është një nismë e cila synon nderimin e 8 mijë viktimave të Srebrenicës, në tërësi burra e djem të besimit mysliman, boshnjakë, të vendosur në një zonë të mbrojtur nga OKB-ja për t'u mbrojtur; synon të shprehë nderimin për viktimat e barbarisë më të madhe pas Luftës së Dytë Botërore të regjistruar në Europë; synon të shprehë solidaritetin me boshnjakët, viktimat të kësaj barbarie; synon të dënojë një akt të pashembullt që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore e deri më sot.

Burra, fëmijë, djem në tërësi, sepse këtë seksion bënin serbët, u grumbulluan në një kamp të mbrojtur nga OKB-ja, por, pavarësisht nga kjo, për shkak të dobësive ekstreme të mbrojtësve të tyre, atje u zhvillua kasaphana më e madhe. Ata që arritën të shpëtojnë nga kampi, u ndoqën pyjeve të Bosnjës dhe u ekzekutua pothuajse çdo njëri prej tyre. Njohja e gjenocidit është një akt i domosdoshëm për kombet dhe shoqëritë e civilizuarat. Ata që nuk njohin gjenocidin, ata kanë ndërgjegje parahistorike. Njohja e gjenocidit është një kusht themelor që ai të mos përsëritet më. Nuk ka asnjë qëllim ndëshkimor këtu ndaj gjeneratës serbe të sotme, por, pa dyshim, udhëheqësit aktualë, me në krye Aleksandar Vuçiqin, janë nga arkitektët e këtij gjenocidi. Aleksandar Vuçiq është regjistruar me zë e figurë teksa thotë në parlamentin e vendit të tij, dhe jo vetëm, se për çdo serb duhet të vriten 100 myslimanë, parimi klasik i gjenocidit të bazuar në urrejtjen fetare. Por ne kemi një detyrim po kaq madhor për ta dënuar këtë gjenocid, i cili theksoj se është sanksionuar në dy vendime të gjykatave më të mëdha të kohës: Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës dhe Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës në ishJugosllavi.

Në rrafshin juridik ky është gjenocid i faktuar universalisht dhe i pranuar nga mbarë vendet e qytetëruara. Dua t'ju them vetëm një moment dhe dua t'ju garantoj se, në rast se Ballkani sot ndodhet

në këtë situatë, në rast se Ballkani nuk ecën drejt Bashkimit Europian, një nga shkaqet më madhore është qëndrimi i gabuar i komunitetit ndërkombëtar ndaj Aleksandër Vuçiqit, i cili është frymëzuesi i gjenocidit serb; dhe pa njohur gjenocidin serb. Ky njeri është një Putin i vogël, i gatshëm t'i ripërsërisë ato në çdo kohë. Po kush jemi ne në raport me gjenocidin serb? Më lejoni të lexoj këtu doktrinën e tyre ndaj gjenocidit shqiptar, e shkruar nga Vaso Çubrilloviç: "Ne serbët nuk kemi armiq më të mëdhenj se shqiptarët. Nëse duam të ngremë kokën tonë, duhet të ulim kokën e tyre. Nëse duhet të ndihemi gjerë të territore, duhet t'i ngushtojmë hapësirat e tyre.

Nëse duam të na dojë bota, duhet të bëjmë që bota t'i urrejë ata. Që shqiptarët ta braktisin vendin e tyre, duhet me çdo kusht dhe çdo mënyrë që t'ua bëjmë jetën ferr. Të arrijmë deri këtu, së pari duhet t'u mohojmë origjinën dhe t'u vrasim krenarinë, t'u shkatërrojmë vatrat, t'u ngatërrojmë emrat, t'u njollosim emblemat dhe simbolet, gjuhën dhe zakonet. T'u rrëmbejmë gjithçka dhe t'i lëmë pa miq rreth e rrotull. Të finalizohet kjo strategji, duhet domosdoshmërisht që antishqiptarizmi të jetë filozofia dhe deviza e vetme e shtetit tonë. Mosqenia e shqiptarëve është vetë ekzistenca e kombit serb". Mbi këtë doktrinë u zhvilluan të gjitha plojat nga 1874 e deri në vitin 1999 mbi shqiptarët. Sot, përveç masakrës së Reçakut dhe të Mejës, do t'ju rikujtoj masakrën e Përbregut. Në të gjitha manualët, traktatet e gjenocidit, një gjenocid mbi shqiptarët është më i padiskutueshmi: ai i Lumës. Vetëm në fshatin Përbreg në vitin 2013 hordhitë serbe mblodhën 422 burra, gra, fëmijë; i hodhën fëmijët nga djepi, nga gjiri i nënës në flakën e mullarit dhe u digjeshin para syve.

A mundemi ne të vëmë në diskutim dhe të mos jemi bashkërisht për dënimin e këtij gjenocidi, për të cilin vetëm një vit më parë Mali i Zi, që ka një përqindje të lartë të popullsisë serbe, se ata që thonë janë filoserbë, ata janë serbë në Malin e Zi, me të gjitha të dhënat, votoi rezolutën e dënimit të gjenocidit serb në Srebrenicë? Çfarë mesazhi u çojmë ne sot shqiptarëve anë e mbanë, kur parlamenti i tyre nuk denoncon, nuk voton në unanimitet një rezolutë që dënon barbarinë më të madhe pas Luftës së Dytë Botërore ndaj një kombi mik, fqinj, siç janë boshnjakët? Shqipëria e ndihmoi gjatë luftës Bosnjën me të gjitha mënyrat. Shqipëria ka marrëdhënie miqësore me Bosnjën dhe do t'i ketë ato marrëdhënie. Është faktori "Dodik" që e pengon këtë shtet të marrë vendimet e duhura.

Ndaj, edhe unë ju ftoj, zotërinj deputetë, ta votojmë këtë rezolutë, si një detyrim madhor të një kombi të qytetëruar, si një detyrim madhor të gjysmës së kombit të martirizuar, si një detyrim madhor për ta detyruar Serbinë t'i njohë krimet e saj, në mënyrë që ta bazojë te paqja dhe jo tek armët ruse e kineze bashkëpunimin me fqinjët e saj. Faleminderit!